



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK.Nr.50/2020**  
**Datë: 21 shkurt 2020**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Nazim Vllaço, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/06/2019-GJA/ADGJTHP.nr.12/2019, të datës 10 janar 2020, në pajtim me Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtareve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 21 shkurt 2020, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **Nazim Vllaço**, gjyqtar në Gjykatën e Themelore në Prizren, **është përgjegjës** për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, dhe 2.12, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve.
- II. Gjyqtarit Nazim Vllaço i shqiptohet sanksion disiplinor **Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej tridhjetë përqind (30%) për një periudhën kohore prej gjashtë (6) muajsh.**

**A r s y e t i m**

Paneli Hetimor, i themeluar me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.220/2019 të datës 25 tetor 2019, pran Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka paraqitur raportin me shkrim mbi hetimin për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/06/19/GJA-ADGJTHP.nr.12.2019, të datës 10 janar 2020, lidhur me shkeljet e subjektit të hetimit Nazim Vllaço, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren.

Për të shqyrtuar këtë çështje KGJK me datë 21.02.2020, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore ku mori pjesë kryesuesi i Panelit Hetimor gjyqtari Behar Ymeri, kurse mungoj subjekti i hetimit gjyqtari Nazim Vllaço.

Kryesuesi i Panelit Hetimor, gjyqtari Behar Ymeri, në fillim të seancës dëgjimore dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se pas zhvillimit të hetimeve ndaj gjyqtarit Nazim Vllaço e bazuar në provat materiale të prezantuara nga Autoriteti Kompetent dhe në pamundësi për ta dëgjuar drejtpërdrejtë subjektin e hetimit disiplinor lidhur me deklaratimet e Autoritetit Kompetent, për shkak të mungesës dhe mos bashkëpunimit të Gjyqtarit Vllaço me Panelin Hetimor ka vërtetuar se gjyqtari Nazim Vllaço, ka bërë shkelje disiplinore kur ne vazhdimësi gjatë muajve gusht dhe nëntor të vitit 2019 ka munguar nga puna dhe për mungesat e tij nuk e ka njoftuar kryetarin e gjykatës dhe askënd tjetër dhe për këtë ka ardh deri të shtyrja e seancave pa arsye në rastet penale P. Nr. 569/2016, P. Nr. 576/2016, P. Nr. 1720/2016 dhe P. Nr. 865/2016.

Po ashtu i njëjti nuk ka marrë pjesë as në shpalljen e aktgjykimit të datës 21 mars 2019, edhe pse me herët ka qenë i njoftuar si anëtar i kolegjit dhe mungesën nuk e ka arsyetuar.

Me këtë ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuar me nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.2 dhe 2.7, dhe 2.12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për të vërtetuar këtë çështje, KGJK ka administruar këto prova: Raportin e Panelit Hetimor mbi faktet dhe provat e mbledhura të datës 10 janar 2020, kërkesën për themelim të panelit hetimor të dërguar nga Autoriteti Kompetent të iniciuar sipas detyrës zyrtare dhe të gjithë provat e tjera të bashkangjitura kësaj lëndë disiplinore.

Pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK-ja vlerësoj se gjyqtari Nazim Vllaço ka dështuar në përmbushjen e obligimeve të tij si gjyqtar kur në mënyrë të vazhdueshme ka munguar nga puna dhe mungesat e tij nuk i ka arsyetuar. KGJK vlerësoj se nga veprimet e tilla të gjyqtarit Vllaço jo vetëm se i është shkaktuar dem palëve por me këto veprime i njëjti ka dëmtuar edhe imazhin e gjykatës së tij dhe të sistemit gjyqësor në përgjithësi. Gjyqtari është i obliguar që me punën dhe sjelljen e tij të veproj në atë mënyrë që të krijoj besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.

Andaj, KGJK vlerësoi se me veprimet e gjyqtari Vllaço, me mungesat e tij të vazhdueshme dhe të pa arsyetuara në punët dhe mos kryerjen e detyrave zyrtare, të cilat kanë pasë për pasojë shtyrjen e seancave, janë përmbushur elementet thelbësore të shkeljes disiplinore të parapara me nenin 5 paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve për çka edhe e gjeti përgjegjës.

KGJK, po ashtu vlerësoi se edhe mos përgjigjja e tij ftesave për pjesëmarrje në seancat e Panelit Hetimor dhe në seancat dëgjimore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, përbënë shkelje disiplinore të njëjtë .

Në seancën për këshillim dhe votim, KGJK me kujdes analizoi se cila nga sanksionet disiplinore i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij disiplinore, vlerësoi se sanksioni disiplinor **Zvogëlim i përkohshëm i pagës prej tridhjetë përqind (30%) për një periudhë prej gjashtë (6) muaj** është sanksioni më i përshtatshëm më të cilin do të arrihet përmirësimi i sjelljes së gjyqtarit.

Vendimi u mor me shumicë të votave nga ana e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me sa u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.Nr.50/2020, datë: 21 shkurt 2020.**

**Skender ÇOÇAJ,**  
**Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës**



#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejt ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Ymer Hoxha, Kryetar në Gjykatën Themelore në Prizren;
- Nazim Vllaço, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren;
- Shkelzen Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i SKGJK-së;
- Arkivit.